



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 21.1.2025

Nr: 25

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E RAPORTIT MBI VEPRIMTARITË PUBLIKE PËR PERIUdhËN 11
JANAR – 18 JANAR 2025**

Sot, më datë 21.01.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me,

OBJEKT: Shqyrtimi i raportit mbi veprimtaritë me karakter publik të disa institucioneve për periudhën 11 janar deri më 18 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

V E N D O S:

1. Miratimin e raportit të gjetjeve mbi veprimtaritë publike për periudhën 11 janar deri më 18 janar 2025, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Kamëz.
3. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.
4. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Lezhë.
5. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Ministrisë për Ekonominë, Kulturën dhe Inovacionin.
6. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive.
7. Fillimin e procedimit administrativ ndaj Bashkisë Cërrik.

Data: 21.1.2025 Nr: 25
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin e raportit mbi veprimtaritë publike për periudhën 11 janar – 18 janar 2025”

8. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
10. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE
Drejtoria e Ligjshmërisë

RAPORTI I GJETJEVE

MBI

VEPRIMTARITË ME KARAKTER PUBLIK TË DISA INSTITUCIONEVE, PËR PERIUDHËN 11 - 18 JANAR 2025

Në lidhje me raportimet e veprimtarive publike në Ndërfaqen e Raportimeve të Institucioneve (NRI), për periudhën 11 janar – 18 janar 2025, konstatohet si vijon:

- **135** institucione publike janë regjistruar në NRI, dhe kanë akses për raportimin e veprimtarive,
- **320 raportime** janë kryer **në total**,
- **294** postime janë aktive,
- **15** janë të ndaluara,
- **11** janë anuluar nga vetë institucioni, (aktiviteti nuk është realizuar ose është shtyrë data e veprimtarisë),
- Në datën **13 dhe 14 janar** ka pasur në total **47** veprimtari jashtë afatit **5 ditë** të raportimit, por, **pa statusin e ndalimit**, për shkak të problemeve teknike/ përditësimeve në modulën e ri të raportimit, të cilat janë zgjidhur,
- Në datën 13 dhe 14.1.2025 e në vijim, **23 raportime janë ndaluar automatikisht** nga sistemi NRI për raportim jashtë afati, nga të cilat, **8 veprimtarive i është hequr shënimi “i ndaluar”** pasi kanë raportuar paraprakisht me e-mail, pa krijuar ende aksesin.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve u ka kërkuar sqarime disa institucioneve dhe i ka kërkuar marrjen e masave për saktësimin e raportimeve, ose, në të kundërt marrjen e sanksioneve administrative për raportime të paplota, për ato institucione të cilat, gjatë raportimit nuk kanë vendosur të gjithë elementët e nevojshëm dhe të domosdoshëm që mundësojnë monitorimin e tyre.

Gjithashtu, u janë kërkuar sqarimet përkatëse, në disa raste kur ka pasur dyshime për veprimtaritë, nëse hynin në kategoritë e veprimtarive të ndaluara.

Është njoftuar Autoriteti i Mediave Audiovizive të marrë masa që mos të lejohet transmetimi apo të pasqyrohet në rubrikat e lajmeve apo ato që mbulojnë fushatën në radio dhe televizion për

veprimtaritë e ndaluara automatikisht nga sistemi, si dhe monitoruesit përkatës për të parë nëse do të zhvillohen veprimtaritë ose jo.

Theksojmë që gjatë datave 13 dhe 14 janar, në ambientet e KQZ, janë zhvilluar trajnimet online me personat e kontaktit, duke i orientuar dhe njëherë në lidhje me detyrimet që burojnë nga Kodi Zgjedhor dhe Vendimi nr. 9/2020 i KRR, i ndryshuar, dhe mënyrën e krijimit të llogarive për raportimin në NRI dhe raportimeve të plota. Në të, kanë marrë pjesë rreth 100 pjesëmarrës, të cilët kanë shtruar për diskutim pyetje dhe problematika të hasura. Jemi munduar të adresohen të gjitha këto problematika dhe kemi bërë dhe përmirësime të modulit të raportimeve, sipas kërkesës së tyre, për të thjeshtëzuar këtë proces.

Për shkak të vështirësive të hasura në javën e parë për periudhën 11 Janar -16 Janar 2025, nga personat përgjegjës për raportimin të institucioneve publike, për veprimtaritë e kësaj periudhe nuk do të ketë shqyrtim të mëtejshëm.

Për datat **17-18 janar 2025**, në ndërfaqen e raportimeve janë ndaluar **11** veprimtari të raportuara nga **6** institucione për shkak të tejkalimit të afatit ligjor, si më poshtë vijon:

- **Bashkia Kamëz** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **2** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Informim/ ndërgjegjësim, *“Informim i publikut nëpërmjet një videoje ilustruese lidhur me funksionimin e sistemit të ri të taksave dhe shërbimet që do mund të marrin qytetarët nëpërmjet tij”*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025,
 - Inspektim, *“Inspektim në Shkollën “Azem Hajdari“ në Babrru*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025.

- **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme** në ndërfaqen e raportimeve ka raportuar **3** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Konferencë/sumit, *“Takim i Ministrave të Jashtëm në formatin: Ukrainë-Evropa Juglindore*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025,
 - Kulturë, *“Aktivitet me rastin e 557-vjetorit të ndarjes nga jeta të Heroit Kombëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu”*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025,
 - Kulturë, *“Pjesëmarrja e Ambasadorit të RSH-së në Shkup Z. Denion Meidani në ceremoninë e vendosjes së kurorave me lule në statujën e Skënderbeut”*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 17.1.2025.

- **Bashkia Lezhë** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Tryezë diskutimesh, *“Arsim”*, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025.

- **Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **2** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Ekonomi, “*Intervistë në emisionin E-ZONE, Vizion Plus, për projektligjin e Paketës së Maleve i parashikuar në buxhetin e 2024*”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 19.1.2025,
 - Kulturë, “*Zv Ministria e Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës, dhe Inovacionit, znj. Lira Pipa, live në Artkand, Top Channel për projektin e fondacionit francez ArtExplora x Vila 31*”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 18.1.2025.
- **Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **1** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - Tryezë diskutimesh, “*Të drejtat e njeriut*”, “*Tryeze diskutimi e organizuar nga IOM (Organizata Ndërkombëtare për Migracionin në Shqipëri) mbi Migracionin dhe Diasporën në nivel vendor me pjesëmarrjen e Strukturave të Migracionit dhe Diasporës të 61 Bashkive, përfaqësues të zyrave vendore të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive*”, raportuar në datën 17.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 21.1.2025.
- **Bashkia Cërrik** ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve **2** veprimtari jashtë afatit të përcaktuar në nenin 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, me tematikë si më poshtë vijon:
 - “*Tjetër*”, “*Kryetari i bashkisë Cërrik është i ftuar në një takim me diasporën në Selanik të Greqisë*”, raportuar në datën 18.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 18.1.2025,
 - “*Tjetër*”, “*Kryetari është i ftuar në një takim me diasporën*”, raportuar në datën 18.1.2025 për t’u zhvilluar në datën 22.1.2025.

KQZ është në monitorim të vazhdueshëm të këtij procesi dhe në vijimësi do duhet që të gjithë institucionet shtetërore të kryejnë raportimet në lidhje me veprimtaritë që planifikohen të zhvillohen prej tyre, të paktën 5 ditë para zhvillimit të tyre dhe në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.